



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 611/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e Rrjetit Ballkanit të Gazetarisë Hulumtuese BIRN me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dega në Prishtinë, për shkak të parregullsive, dhe manipulimit të votova, dhe vendosjes së posterave në afërsi të qendrave të votimit në Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e palejuar ankesa e Rrjetit Ballkanit të Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesa më datë 04.11.2013, me Anr. 611/2013 nga Rrjeti Ballkanit i Gazetarisë Hulumtuese BIRN me seli në Prishtinë kundër subjektit politik PDK, me të cilën pretendohet se shkelja e rregullave gjatë votimit me asistencë .

PZAP-i, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it të datës 07.11.2013, Anr. 597/2013. Pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në ankesë pasi që ankesa është e njejtë Anr.610/2013. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it ,si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 611/2013 më datën 07.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Hasan Shala



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i,*